



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/25

Datë: 17.04.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe të Rregullores Nr. 06/2012 për Pozitat e Larta Drejtuese në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 05/2020 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 17 prill 2020, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Znj. Edi Gusia, i vazhdohet mandati i Kryeshefes Ekzekutive të Agjencisë për Barazi Gjinore edhe për 3 (tre) vjet.
2. Znj. Gusia, kryen të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë e përcaktuara me legjislacionin në fuqi.
3. Obligohet Zyra e Kryeministrit për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Albin KURTI

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/25

Datë: 17.04.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 73 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe të nenit 18 të Rregullores nr. 06/2012 për Pozitat e Larta Drejtuese në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 05/2020 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 17 prill 2020, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Themelohet Komisioni Disiplinor për shqyrtimin e rastit të Kryeshefit Ekzekutiv të Agjencisë për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar ose të Konfiskuar, në këtë përbërje:
 - 1.1. Haki Abazi, Zëvendëskryeministër, kryesues;
 - 1.2. Xhelal Svecla, Ministër i MPBAP, anëtar;
 - 1.3. Emilija Redzeqi, Ministre e MAPL, anëtare;
 - 1.4. Naim Bardiqi, Sekretar i Përgjithshëm i MSH, anëtar;
 - 1.5. Edi Gusia, Kryeshefe Ekzekutive në ABGJ, anëtare.
2. Komisioni Disiplinor nga pika 1. e këtij vendimi kryen detyrat dhe përgjegjësitë e përcaktuara me Ligjin Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, me Rregulloren Nr. 06/2012 për Pozita e Larta Drejtuese në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe me aktet tjera përcjellëse.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Albin KURTI

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/25

Datë: 17.04.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 05/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 17 prill 2020, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Udhëzimi Administrativ për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ (QRK) Nr. 03/2016 për masat e veçanta për regjistrimin e pronës së paluajtshme të përbashkët në emër të dy bashkëshortëve.
2. Obligohet Zyra e Kryeministrit dhe institucionet tjera përkatëse për zbatimin e Udhëzimit nga pika 1. e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Albin KURTI

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/25

Datë: 17.04.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 05/2020 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 17 prill 2020, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Shfuqizohet Udhëzimi Administrativ (QRK) Nr. 03/2018 për gjuhët e huaja në programin e studimit të ciklit të dytë apo të tretë.
2. Obligohet Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit dhe institucionet e Arsimit të Lartë për zbatimin e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Albin KURTI

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 05/25
Datë: 17.04.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 4 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 05/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 17 prill 2020, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet në parim Nisma e Ministrisë së Financave dhe Transfereve për negocimin e Marrëveshjes në mes të Republikës së Kosovës, e përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Transfereve, dhe Komisionit Evropian për "Marrëveshjen e Prokurimit të Përbashkët për Prokurimin e Kundërmasave Mjekësore".
2. Përgjatë negocimit të kësaj marrëveshjeje, Ministria Financave dhe Transfereve obligohet të procedojë konform dispozitave të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare dhe dispozitave tjera në fuqi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Albin KURTI

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 06/25

Datë: 17.04.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 05/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 17 prill 2020, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Në pikën 1. nën pika 1.2 e Vendimit Nr. 01/19 të Qeverisë së Republikës së Kosovës për aprovimin e Pakos Emergjente Fiskale, i datës 30.03.2020, fjalët "pagesë mujore në vlerë më të ulët se njëqind (100 €) euro" ndryshohen me fjalët "pagesë mujore me vlerë deri në njëqind (100 €) euro".
2. Në pikën 1. nën pika 1.3 e Vendimit Nr. 01/19 të Qeverisë së Republikës së Kosovës për aprovimin e Pakos Emergjente Fiskale, i datës 30.03.2020, pas fjalës "shoqëritë tregtare" shtohen fjalët dhe punëdhënësit tjerë".
3. Në pikën 1. nën pika 1.6 e Vendimit Nr. 01/19 të Qeverisë së Republikës së Kosovës për aprovimin e Pakos Emergjente Fiskale, i datës 30.03.2020, fjalët "Stafi mjekësor (mjekët dhe infermierët)" ndryshohen me fjalët "Stafi mjekësor dhe mbështetës (mjekët, infermierët dhe personeli tjetër i ekspozuar rrezikut)".
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Albin KURTI

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 07/25

Datë: 17.04.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 33 të Ligjit Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 05/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 17 prill 2020, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Raporti i vlerësimit të përshtatshmërisë së sistemit të financimit të komunave për vitin 2019.
2. Obligohet Ministria e Financave dhe Transfereve dhe ministritë e linjës për zbatimin e rekomandimeve nga ky Raport.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Albin KURTI

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 08/25

Datë: 17.04.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 73 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe të nenit 18 të Rregullores nr. 06/2012 për Pozitat e Larta Drejtuese në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 05/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, sipas kërkesës së Ministrit të Integritimit Evropian, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 17 prill 2020, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Themelohet Komisioni Disiplinor për shqyrtimin e rastit të Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Integritimit Evropian, në këtë përbërje:
 - 1.1. Haki Abazi, Zëvendëskryeministër, kryesues;
 - 1.2. Xhelal Svecla, Ministër i MPBAP, anëtar;
 - 1.3. Emilija Redzeqi, Ministre e MAPL, anëtare;
 - 1.4. Naim Bardiqi, Sekretar i Përgjithshëm i MSH, anëtar;
 - 1.5. Edi Gusia, Kryeshefe Ekzekutive në ABGJ, anëtare.
2. Komisioni Disiplinor nga pika 1. e këtij vendimi kryen detyrat dhe përgjegjësitë e përcaktuara me Ligjin Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, me Rregulloren Nr. 06/2012 për Pozita e Larta Drejtuese në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe me aktet tjera përcjellëse.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Albin KURTI

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 09/25

Datë: 17.04.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 05/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 17 prill 2020, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet në parim Nisma për lidhjen e "Marrëveshjes për heqjen reciproke të vizave për mbajtësit e pasaportave diplomatike dhe zyrtare" ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Saint Lucia.
2. Obligohet Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës që të zhvilloj negociata me Qeverinë e Saint Lucia me qëllim të finalizimit të tekstit përfundimtar të marrëveshjes së lartcekur, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Albin KURTI

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 10/25
Datë: 17.04.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 4 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 05/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 17 prill 2020, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet në parim Nisma e Ministrisë së Financave dhe Transfereve për negocimin e Marrëveshjes në mes të Republikës së Kosovës, e përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Transfereve, dhe Shoqatës për Zhvillim Ndërkombëtar (Banka Botërore) për projektin "Nxitja dhe Levimi i Mundësive për Sektorin e Ujit (P169150)".
2. Përgjatë negocimit të kësaj marrëveshjeje, Ministria Financave dhe Transfereve obligohet të procedojë konform dispozitave të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare dhe dispozitave tjera në fuqi.
3. Vendimi hyn në fuqi në datën e nënshkrimit.

Albin KURTI

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë